



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:268671
Datë: 21.02.2024
Numri i dokumentit: 05352527

AA.nr.601/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses F.H, Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga F.H1, Komuna Kaçanik, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1712/2018 të datës 03.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1712/2018 i datës 03.05.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1712/2018 të datës 03.05.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses F.H, Komuna e Kaçanikut dhe anulohet vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës 15.12.2017 dhe vendimi i datës 03.04.2018 dhe paditëses i njihet e drejta në kompensimin retroaktiv për shumën mujore për kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë nga data e parashtrimit të kërkesës 26.05.2017, e deri më datën e aktgjykimit 03.05.2023 me të cilin i njihet e drejta-kompensimi, kurse nga data 04.05.2023 deri nga data 02.05.2028 i njihet e drejta në vazhdim për kompensimin sipas shumës mujore për kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë dhe kompensimi bëhet në baza mujore për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë në shumën e cila aplikohet për këtë lloj kompensimi, si kompensim më i favorshëm për paditësin. Në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses t’ia kompensoj në mënyrë retroaktive pagesat mujore të papaguara në emër të kompensimit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë nga data 26.05.2017, në shumë të përgjithshme të kërkuar prej 18,225.00 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e pesë) euro, si dhe shumën prej 2,838.00 (dy mijë e tetëqind e tredhjet e tetë) euro për kamatën ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë 13.07.2018, të gjitha këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit

me dhunë. Në pikën III të dispozitivit është vendosur që pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën II të dispozitivit paditësi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor. Në pikën IV të dispozitivit është vendosur se ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar të prishet ashtu që të mbetet në fuqi vendimi i datës 15.12.2017 dhe dt. 03.04.2018.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin me nr. 738 të dt.03.04.2018 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e z/znj. F.H, me numër të ID-së... për njohjen e të drejtës në kompensim për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë.

Paditësja e pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 13.07.2018, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditëses të paraqitur kundër vendimit të lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës vlerëson se me qëllim të vendosjes meritore në këtë çështje juridike administrative gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në neni 43.3 të Ligjit për Konflikte Administrative dhe për të vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje, ka kthyer në plotësim ekspertizën mjekësore të datës 27.08.2021. Me aktin përcjellës të datës 29.09.2022 është dorëzuar ekspertiza në përbërje të ekspertëve Dr.F.A-neurolog, Dr.F.A-neurolog dhe Dr.B.B-fiziatër, në të cilën ekspertizë referohet konstatimi se paditësja *hyn në personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik ka humbur në formën e përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të të katër ekstremiteteve-tetraplegjik, sipas Ligjit nr.05/L-067 për njohjen e statusit dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, paaftësia është e përhershme dhe në total është 90 %*. Ekspertiza nuk është kundërshtuar nga përfaqësuesja e të paditurës në seancën e shqyrtimit gjyqësor. Nga vlerësimi i mendimit të komisionit mjekësor të QKUK-së në plotësimin e ekspertizës mjekësore është konstatuar se paditësja hyn në grupin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik pasi që konstatohet se ka humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të të katër ekstremiteteve dhe po ashtu nga shkresat e lëndës konstatohet se qysh nga viti 2017 paditëses edhe nga vet e paditura i është njohur e drejta në grupin e dytë të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, andaj paditësja i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë ku gjykata e shkallës së parë kishte parasysh Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik përkatësisht nenin 3 paragrafi 1, nenin 7 par. 2 dhe po ashtu neni 8 paragrafi 1 të po të njëjtit Ligj. Si dhe në kuptim të nenit 9 paragrafi 1 të Rregullore (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në bazë të mendimit të dhënë nga

Komisioni Mjekësor i QKUK-së sipas plotësimit të ekspertizës mjekësore, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, vërtetohet se paditësja i plotëson kushtet për njohjen e të drejtës në kompensimin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë, i përcaktuar nga neni 3 dhe neni 7 paragrafi 1 të Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe mbi këto arsye edhe vendimin kontestues e konstaton si jo të drejtë dhe jo të ligjshëm. Me nenin 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet:” Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me njohjen e të drejtës dhe kompensimin si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij vendimi gjykata e shkallës së parë kishte parasysh kërkesën dhe parashtrimin e saj. Lidhur me periudhën e vendosjes si në pikën I-II të dispozitivit u vendos në kuptim të nenit 9 paragrafi 1 të Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Si dhe në kuptim të nenit 9 paragrafi 1 të Rregullore (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Lidhur me kompensimin e përcaktuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë kishte parasysh po ashtu nenin 26 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Lidhur me kamatën gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, lartësia e shumës së kompensimit u vendos në kuptim të nenit 7.1 të Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, ku po ashtu sipas propozimit të paditëses Gjykata e shkallës së parë ka caktuar ekspertizën financiare ku është përcaktuar shuma e përgjithshme si dhe kamata prej 8 % e përcaktuar në shumën e kërkuar. Sipas propozimit të paditësit Gjykata e shkallës së parë ka caktuar ekspertizën financiar nga e cila përcaktohet shuma e kompensimit përkatësisht diferencës për grupin e parë dhe atë nga data 26.05.2017 për të cilën paditësja është kompensuar për grupin e dytë, kompensimin sipas grupit të parë, nga muaji 05/2020, e deri më dt.27.01.2021, kurse nga data 27.01.2021, diferenca në mes të kompensimit për persona për paafhtësi të përhershme të cilën e ka përfutur paditësja dhe diferencës me kompensimin për grupin e parë të paraplegjik deri më datën e ekspertizës.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka vendosur kur kërkesëpadinë e paditësit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura nga ana e të paditurës, të njëjtat gjykata e shkallës së parë i refuzon pa ndonjë arsye të mirëfilltë e që do të bënin të paditurën të pranojë një vendim të tillë, po ashtu se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke mos marrë parasysh gjendjen faktike të konstatuar nga Komisioni Mjekësor pranë të paditurës, pastaj se kontaktimi i gabuar

dhe jo i plotë i gjendjes faktike konsiston në faktin se gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit të çështjes juridike nuk i mori parasysh faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes. Më saktësisht gjykata e shkallës së parë aprovoi kërkesëpadinë e paditëses edhe pse nga Komisioni Mjekësor ishte konstatuar se paditësja F.H nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me ligj. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, meqë nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ është vërtetuar se paditësja i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar, e në veçanti nga ekspertiza mjekësore e datës 29.09.2022 e mjekëve specialist të cilës gjykata e shkallës së parë me të drejtë ja fali besimin në tërësi, e cila është profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar, për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ. Pra gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate po ashtu nuk i aprovoi, për faktin se ekspertiza mjekësore është e qartë dhe nuk ka kontradiktë në vete, si dhe e paditura nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re. Andaj, të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykimi i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.601/2023, me datë 14.02.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi